



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 33.
Prishtinë, më 28.02.2012 në ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lirije Kajtazi, Glauk Konjufca, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Rasim Demiri dhe Etem Arifi.

Munguan: Lumnije Morina, Petar Miletic dhe Mufera Sinik

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësuesja nga OSB, Elita Vokshi, Florina Shala përfaqësuesi nga zyra e ICO-së Dejan Cosic, përfaqësuesi nga zyra e KDI-së Shkumbim Beqiri, përfaqësuesi nga Presidenca Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe, me raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapsinor, me amendamente.**

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me të vetmen pikë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Krzesuesi - konstatoi se për këtë takim Komisioni për Komunitete dhe Kthim ka ftuar të merr pjesë Ministrin e MPH, z. **Dardan Gashi** me qëllim të ofrimit të informatave dhe sugjerimeve të nevojshme lidhur me propozim amendamentet e Qeverisë në Projektligjin për fshatin Hoçë e Madhe.

Me theks të veçantë tha se në kuadër të harmonizimit të qëndrimeve në amendamentet e propozuara të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor si dhe amendamentet e Qeverisë në Projektligjin për fshatin Hoçë e Madhe, Komisioni ka mbajtur takim të përbashkët me dy komisionet dhe takim të përbashkët të kryetarit dhe zëvendësve të të dyja komisioneve, dhe se janë përafëruar qëndrimet tona ndërsa ka mbetur kontestues harmonizimi i amendamenti 1, të nenit 4 të Qeverisë, për shkak se përmbajtja e ndryshimeve të propozuara në aspektin gjuhësor nuk përputhen.

Ai tha se në bazë të propozimit të amendamentit 1 të Qeverisë, Këshilli përbëhet nga 7 anëtarë, dhe se ky përfaqësim përputhet në aspektin gjuhësor, ndërsa paragrafët në gjuhën serbe kanë këtë përbërje: paragrafi 3,1. pesë anëtarë të zgjidhur drejtpërdrejtë nga qytetarët e zonës kadastrave të Hoçës së Madhe, paragrafi 3,2 një anëtarë i zgjedhur nga Komuna kurse paragrafi 3,3 , një anëtarë i zgjedhur nga Kisha Ortodokse. Ky përfaqësim i paragrafëve nuk është i harmonizuar me versionin në gjuhën shqipe. Andaj kërkoi nga ministri të ofrohet interpretimi konkret lidhur me harmonizimin e ndryshimeve në versionet gjuhësore.

Dardan Gashi- ministër i MPH , dha sqarim se gjatë hartimit të projektligjit janë dhënë disa propozime nga grupi punues i Qeverisë së bashku me përfaqësuesit e ICO-së. Sa i përket amendamentit 1, neni 4, i Projektligjit për fshatin Hoçë e Madhe, tha se është mosharmonizim i teknik i tekstit të ligjit. Ai shtoi se versioni përfundimtar definohet me : tre anëtarë të zgjidhur drejtpërdrejtë nga qytetarët e zonës kadastrave të fshatit Hoça e Madhe, tre anëtarë nga Komuna e të dhe një anëtarë nga Kisha Ortodokse serbe.

Vjosa Vela – theksi se pas diskutimeve të shumta me përfaqësuesit e ICO-së jemi akorduar që këshilli të ketë përbërjen e njëjtë të anëtarëve, si nga Kuvendi Komunal ashtu edhe nga zona kadastrave e Fshatit Hoça e Madhe dhe një anëtar nga Kisha Ortodokse serbe.

Krzesuesi – theksoi se me Ligj duhet të precizohet themelimi i Këshillit në përbërje prej tre anëtarëve të komunitetit serb nga zonës kadastrale e fshatit Hoçë e Madhe. Pyetja për ministrin ishte se a mundet të jenë të përfaqësuar edhe pjesëtar të komuniteteve tjera

Dardan Gashi- tha se në zonën kadastrave të fshatit Hoça e Madhe shumica absolute janë përfaqësues të komunitetit serb, nga se edhe në projektligj është precizuar që tre anëtarë të zgjidhen drejtpërdrejtë nga zona kadastrave dhe një përfaqësues nga Kisha Ortodokse serbe. Mendon se me nenin 4, është arritur maksimumi i punës së Qeverisë, andaj këto janë arsyet e mjaftueshme që në ligj të mos precizohet komuniteti.

Glauk Konjufca.- pyetje për ministrin ishte se sa janë në dijeni për bashkëpunimin e të dyja komisioneve lidhur me qëndrimin dhe harmonizimin e amendamenteve të propozuara nga Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor në Projektligjin për fshatin Hoçë e Madhe,

Nën dy, ngriti çështjen se në bazë të cilave fakte Qeveria ka planifikuar zgjedhjen e Këshillit dhe ka bërë ndarjen proporcionale të përfaqësimit të anëtarëve, tre me tre dhe një anëtarë i zgjedhur nga Kisha Ortodokse serbe. Ai mendon se kjo përbërje e këshillit mund të jetë precedent sepse krijohen hapësira brenda Kosovës, me që dihet se fshati gëzon autonomi absolute, si në nivel lokal ashtu dhe në nivel qendror.

Dardan Gashi- theksoi se ka njohuri për rrjedhën e punës së komisionit funksional në hartimin e amendamenteve në Projektligjin për fshatin Hoçë e Madhe.

Në diskutimin e tij tha se si sponzorues qëndrojnë pran amendamenteve të propozuara nga zyra e tyre. Sa i përket këshillit, vet fjala tregon se është organi këshillëdhënës i cili ka të vetmen mundësi të kërkojë sqarime shtese, të komentoj në vendime, por nuk mund ti zbatoj, andaj shtoi se si organ nuk ka autoritet ekzekutiv.

Elmi Reçica – Në fjalinë e tij tha se komisioni për Komunitete ka mbajtur takime të përbashkëta me dy komisionet dhe takimit të përbashkët me kryetarët dhe zëvendëskryesuesit e të dyja komisioneve. Në kuadër të rrjedhave nga këto takime dhe në bazë të bashkëpunimit me përfaqësuesit e ICO-së jemi akorduar për miratimin e të gjitha amendamenteve të komisionit funksional përveç nenit 4, dhe se komisioni ka votuar propozimin amendamentin 1 të Qeverisë.

Ai shtoi se ka mbetur diskutues çështja e përfaqësuesit të anëtarëve në Këshill, prandaj kërkoi nga ministri sqarime, se anëtarët duhen të jetë të zgjedhur nga Kisha Ortodokse Serbe apo ndonjë përfaqësues nga fshati Hoçë e Madhe

Dardan Gashi- në fjalinë e tij tha se e njëjtën strategji është përdorur edhe në Projektligjin e Prizrenit ku thuhet se bashkësitë fetare kanë të drejtë të zgjedhin një përfaqësues por jo të prezantohen drejt për drejt. Andaj edhe me Projektligjin për fshatin Hoçë e Madhe, është rregulluar që Kisha Ortodokse Serbe nuk bënë zgjedhjen e përfaqësuesve por vetëm mund të japin propozimin e tyre.

Galuk Konjufca- sa i përket versionit të amendamentit 3,3 të Qeverisë, thuhet se një anëtar duhet të zgjidhet nga Kisha Ortodokse Serbe ndërsa sipas amendamentit të komisionit funksional thuhet se përfaqësuesi duhet të jetë banor i fshatit Hoçë e Madhe. Andaj kërkoi informata shpesh se cili version është i saktë.

Dardan Gashi- diskutoi se Kisha Ortodokse Serbe ka të drejtë në përzgjedhjen e një anëtar që është banor i fshatit Hoçë e Madhe dhe i cili drejtpërdrejtë përfaqëson interesat e tyre

Vjosa Vela –lidhur me përbërjen e Këshillit, dha sqarim se zona e veçantë e Hoçës së Madhe është më e vogël se fshati, për këtë arsye janë propozuar tre anëtar prej fshatit dhe një anëtarë nga zona e cila i takon Kishës Ortodokse Serbe.

Elmi Reçica - propozoi që vërejtjet në amendamentin 1, të nenit 4 të propozuar nga Qeveria të dërgohen për shqyrtim komisionit funksional ku të njëjtat do të rishqyrtohen nga komisioni i jonë, dhe do të marrim qëndrim konkret.

Kryesuesi konstatoi se pas diskutimeve të shumta të propozimeve amendamenteve të Qeverisë në Projektligjin për fshatin Hoçë e Madhe, me shumicë votash nxori këtë:

Përfundim

Në bazë të sqarimeve të dhëna nga propozuesit, Komisioni mori informata se versioni autentik është në gjuhën shqipe dhe propozimi i ndryshimeve nuk është harmonizuar me versionin në gjuhën serbe për shkak të gabimeve teknike.

Në pajtim me këtë, i rekomandohet komisionit funksional që edhe njëherë të shqyrtojë amendamentin 1, të nenit 4 dhe amendamentet tjera në bazë të cilave është arritur konsensusi, me qëllim të sigurimit që të drejtat dhe interesat e komuniteteve të trajtohen në mënyrën adekuate të përcaktuara me ligj, dhe pas kësaj raporti final me amendamente t'i dërgohet për shqyrtim Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic